

L I G J
Nr.7821, datë 11.5.1994

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7678, DATË 3.3.1993 “PËR AKCIZAT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN R.7730, DATË 20.7.1993**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I :

Neni 1

Në shkronjën “f” të nenit 3 të ligjit nr.7678, datë 3.3.1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Përqindja e akcizës

- vajguri prodhim vendi.....16

- Paragrafi me fjalët: “Me përjashtim të vajgurit, energjisë elektrike dhe gazit të lëngët që i shitet popullatës” shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare” dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 1994.

Shpallur me dekretin nr.845, datë 20.5.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.